



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 130, datë 28.07.2021**

**PËR  
LICENCIMIN E SHOQËRISË “BANKA UNION” SH.A. PËR OFRIMIN E  
SHËRBIMEVE TË INVESTIMIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, si dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

**1. Licencimin e shoqërisë “Banka Union” sh.a. për ofrimin e:**

**Shërbimeve të investimit:**

- Marrje dhe transmetim i urdhrave në lidhje me titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë;
- Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve; dhe
- Tregtim për llogari të vet.

**dhe shërbimit ndihmës:**

- Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.

**2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**